



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:273053

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810671

KPPP.nr. 2113/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Komuna e Obiliqit me seli në Obiliq, rr. "Adem Jashari", nr. 2, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Drita Hashani, kundër debitorit A.V. B.I., me emër tregtar "Sejda & Farm", me numër unik identifikues 810730805 dhe seli në Obiliq, rr. "Hasan Prishtina", p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Rrecaj, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 1100/23 të datës 16.11.2023, të Përbaruesit Privat Flamur S. Curri, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit A.V. B.I., me emër tregtar "Sejda & Farm", ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 1100/23 i datës 16.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Curri, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Obiliqit, me datë 16.11.2023, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 1100/23, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Aktvendimit Nr. IV-145/2022, të datës 21.03.2022, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin në emër të përmbushjes së obligimeve t'ia paguajë kreditorit shumën prej EUR 2,100.00, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetim se është lejuar urdhri përbarimor në kundërshtim me dispozitat ligjore të procedurës përbarimore, si dhe të njëjtin e ka lejuar për

kërkesa të parashkruara nga viti 2014 deri në vitin 2020, sipas nenit 353 të LMD-së, madje për vitet 2014 deri në vitin 2017 ka humbur edhe e drejta e kërkesës sipas nenit 354 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 104.00 EUR, sipas tarifës së OAK-së.

Kreditore, përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se sa i përket parashkrimit të borxhit, për kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vite, madje edhe për ato për të cilat ligji parasheh afat më të shkurtër për parashkrim, sipas nenit 361, par. 1 të LMD-së. Rrjedhimisht, në rastin konkret ka kërkesë të vërtetuar nga Komuna, që është organ kompetent për mbledhjen e taksave komunale. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se Aktvendimi Nr. IV-145/2022 i datës 21.03.2022, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit pasi që dokumenti i lartcekur, trajtuar në cilësi të vendimit të organit administrativ, nuk përmban klauzolën e përmbartueshmërisë ashtu siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së i cili përcakton se *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*.

Andaj, në kuptim të nenit 24 të LPP-së i cili parasheh se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, gjykata vlerëson se Aktvendimi Nr. IV-145/2022, të datës 21.03.2022, në mungesë të klauzolës së përmbartueshmërisë, nuk mund të vërtetohet se a është bërë i pambarueshëm sipas rregullave të procedurës me të cilën është nxjerrë.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi*

*përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë”* Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, ashtu që të njëjtin e aprovoj si të bazuar, duke anuluar Urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 1100/23 të datës 16.11.2023.

Nga si më sipër, e në mbështetje të nenit 73 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe neni 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2113/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.